

# Raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën

## Janar – Dhjetor 2020

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve, ka si qëllim kryesor të sigurojë zbatimin e legjislacionit të punës në subjektet fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj, privatë ose publik, që ushtrojnë veprimtari ekonomike fitimprurëse apo jo fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit që mbulon fushën e punës është kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi. Ky mision realizohet nëpërmjet procedurave të inspektimit në punë si dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor përkatës.

Inspektorati Shtetëror i Punës ngarkohet:

Të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjenën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;

T'u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore;

Të vërë në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.

Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit, por edhe të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në Ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore” si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 20.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2020”, në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për 12-mujorin vitit 2020, për Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Në tabelën në vijim, po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhënat mbi buxhetin e miratuar dhe realizimin e tyre sipas artikujve.

|           |                 |                      | 12/ MUJORI (000)                        |                                    |
|-----------|-----------------|----------------------|---|------------------------------------|
| Artikulli | Emërtimi        | Buxheti vjetor Plani | Buxheti vjetor Plani 12-mujor/progresiv | Realizimi fakti 12-mujor progresiv |
| 600+601   | Paga Sigurime   | 133.864              | 133.864                                 | 120.721                            |
| 602       | Mallra Shërbime | 31.436               | 31.436                                  | 19.420                             |
| 231       | Investime       | 1.300                | 1.300                                   | 1.292                              |
| 606       | Fondi i vecante | 300                  | 300                                     | 145.3                              |
|           | <b>TOTALI</b>   | <b>166.900</b>       | <b>166.900</b>                          | <b>141.578,8</b>                   |

Në mënyrë analitike, performaca e objektivave dhe realizimit të shpenzimeve për 12-mujorin e vitit 2020 për Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve, për periudhën Janar-Dhjetor 2020, është si më poshtë:

Buxheti i miratuar për vitin 2020 është 186.600 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr.15, datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, janë bërë pakësime në zërat e buxhetit, (art. 600+601),paga dhe sigurime në 6.500 mijë lekë dhe në zërin art.buxheti 602 në 4.500 mijë lekë, gjithashtu në zërin e investimeve pas këtyre ndryshimeve buxheti vjetor plani i periudhës është 166.900 mijë lekë.Përsa i përket pjesës tjetër të fondeve të planifikuara nën zërin e investimeve është kryer rialokim fondi në projektin “rikonstruksion godine për zyrat Rajonale, Gjirokastrë” duke e kaluar këtë shumë në zërin “Blerje pajisje elektronike” për të cilin është dërguar kërkesa pranë AKSH-it si organ qëndror blerës.

Buxheti i planifikuar për 12- mujorin e vitit 2020 është 166.900 mijë lek. Realizimi i shpenzimeve për këtë periudhë është 141.579 mijë lekë.

## Shpenzime Korrente

### 1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 për zërin paga dhe sigurime është 133.864 mijë lekë dhe janë shpenzuar 120.721 mijë lekë ose 90.18% e planit vjetor të 2020.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat dhe sigurimet e punonjësve të ISHPSHSH-së.

### 2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera Operative.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 është 31.436 mijë lekë, ku fondi i planifikuar për Shpenzime për Mallra dhe Shërbime, për periudhën Janar-Dhjetor 2020 është shpenzuar në masën 19.420 mijë lekë. Me këtë zë shpënzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si drita, ujë, telefon, elektricitet, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë etj.Në këtë artikull janë kryer shpenzime për dieta Brenda vendi, në funksion të veprimtarisë inspektuese.

### 3- Transferta, Fond i Veçantë. Llogaria 606

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 është dhënë Fond i Veçantë në vlerën 300 Lekë për daljen e punonjësve në pension, raste sëmundjeje dhe është realizuar në masën 145,3 Lekë.

#### **4- Shpenzime për Investime kapitale**

Bazuar në Ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale ishte në shumën 10.000 mijë lekë nga të cilat 10.000 lekë investime me Financim të Brendshëm. Janw bwrw disa ndryshime: me Aktin normativ Nr.28 datë 02.07.2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.88/2019", Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, është bërë pakësim në investimeve në zërin e “Blerje automjete” në shumën 8.000 (tetëmijë)lekë dhe sipas planit të rishikuar të buxhetit me Aktin Normativ Nr.34, datë 16.12.2020” pakesohet me 700 (shtatëqind)lekë nw zwrin e “Blerje paisje elektronike.Shpenzime kapitale art.nr.231 është realizuar 100%.

Gjithashtu mungesa e stafit të nevojshëm administrativ dhe situata e krijuar në vazhdimësi nga Pandemia Covid-19 ka shkaktuar vonesa në prokurime dhe ne realizime sipas planit për 12-mujorin e vitit 2020.

Dëshirojmë të theksojmë se mosrealizimi i fondeve, ka ardhur për shkaqe objektive, por kjo nuk do të ndikojë në performacën e këtyre shpenzimeve në vijim.

Bashkëlidhur do të gjeni tabelat shoqëruese të raportit të monitorimit për 12-mujorin e vitit 2020.